



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 23/06/2025			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
	05-400/14-	23	587



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12, pika 12.2 dhe Rregulloret Komunale për Subvencione nr: 02 Nr.400/01-19798 të dt:29.05.2025, Nr.02-400/01-18380 të dt.27.04.2022, Rregullores 12 Nr.320-19338, të datës 07.04.2017 dhe duke u bazuar në planin e punës për vitin 2025 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik shkallë:

THIRRJEN PUBLIKE
”FONDI PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START - UP ”

Bazuar në rregulloret komunale për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Komunën e Drenasit, në kuadër të ” Programit Start- Up” shpallë konkurs për mbështetje financiare duke iu dhënë prioritet më shumë, zeje tradicionale, ideve inovative, ideve në fushën e turizmit, ideve që ofrojnë me shumë punësim. Vlera e financimit do të jetë nga përzgjedhja e përfituesit, që bëhet në mënyrë konkurruese. Shuma maksimale e përfitimit është **1,500.00 €** dhe përcaktohet nga plotësimi i kriterëve të shënuara më poshtë:

1. KRITERET E FINANCIMIT:

- Përfituesit Start UP, regjistrimi i biznesit bëhet pas vlerësimit preliminar nga komisioni.
- Të gjeneroj punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësoj së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi;
- Bizneset të cilat promovojnë ide kreative dhe inovative në tregun tonë do të kenë përparësi.
- Përfituesit e grantit duhet të kene kujdes të duhur në ruajtje të ambientit nga ndotja e mundëshme prej operimit të biznesit të tyre;
- Përparësi kanë Start up që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 40 vjeqare dhe në fushën e artizanateve;
- Plani i investimit duhet të specifikohet mirë, kështu që në momentin e aplikimit biznesi duhet të sjellë profaturën për paisjen/paisjet, sipas planit të Investimit;
- **Start Up duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, më së paku më 20% të vlerës së grantit të fituar, varësisht nga vlera e grantit të fituar.**

2. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM PËR START-UP BIZNES:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Pëlqimin sanitar nga drejtoria e inspeksionit dhe Licenca nga ministria e përkatëse e linjës (mund të kërkohet nga komisioni, nëse konsiderohet e nevojshme, gjatë vlerësimit);
- Pro faturën e rregullt me të gjitha shënimet e duhura si: numri i regjistrimit të biznesit, numri i pro faturës, emri i plotë i furnitorit (shitësit), adresa e saktë, nënshkrimi dhe vula e shitësit, dhe të gjitha të dhënat tjera të rëndësishme për furnitorin ku do të blihet pajisjet, specifikacionin dhe fotot e pajisjeve apo mjeteve të punës me çmimin kushtues (pro fatura sjellë në fazën e aplikimit);
- Vertetimin nga Gjykata se nuk është nën hetime.

Verejtje: Aplikuesit që shpallen përfitues preliminar duhet të regjistrojnë bizneset e tyre dhe të hapin xhirollogaritë e biznesit, para se të shpallen përfitues final.

3. KRITERET JO KUALIFIKUESE:

Start-Up nuk kualifikohet nëse:

1. Ka qenë përfitues nga DZHE në thirrjen e fundit;
2. Kërkon mjete për të blerë tokën për ndërtim të objektit;
3. Përfitues të subvencioneve nuk mund të jetë personi fizik jo rezident i komunës.
- 4.

4. SI TE APLIKOHET?

Aplikacioni merret direkt ne zyrën e DZHE, ose në web faqen e Komunës së Drenasit. Aplikacioni i shkarkuar plotësohet (forma elektronike ose me dorëshkrim), te cilën se bashku me dokumentacionin mbështetës që kërkohet më poshtë, e dorëzoni në arkivin komunale (kati i parë).

5. **FAZA E PARË E E KUALIFIKIMIT:** Nëse kaloni fazën e parë të selektimit, në bazë të dokumentacionit të prezantuar, atëherë do të kontaktohen nga zyrtarët komunal DZHE për hapat e më tutjeshëm.
6. **FORMA E PAGESES:** Nëse zgjidheni përfitues, nënshkruhet Kontrata me Komunën/DZHE, përfituesi duhet të prezantoj faturën me të cilën dëshmohet blerja e pajisjes/ve, së bashku dëshminë e transferit bankar nga xhirollogaria e biznesit tuaj tek operatori ekonomik (shitësi), si dhe verifikimi në teren nga ana e komisionit kompetent., Komuna e bënë rimbursimin e mjeteve financiare në vlerë të grandit.
7. **AFATI I APLIKIMIT:** Afati i aplikimit është nga data e shpalljes deri 11 Korrik 2025 (ora 16:00). Pas këtij afati, aplikacionet nuk pranohen.

DREJTORI I DREJTORATIT

Agnesë Kastrati Bucolli



Drenas, 23.06.2025